REPUBLIKA E KOSOVËS · REPUBLIKA KOSOVA · REPUBLIC OF KOSOVA
QEVERIA E KOSOVËS · VLADA KOSOVA · GOVERNMENT OF KOSOVA
ZYRA E KRYEMINISTRIT · URED PREMIJERA · OFFICE OF THE PRIME MINISTER
SEKTORI I ARKIVËS · SEKTOR ARHIVE · ARCHIVE SECTOR
Njësia Org. / Org. jedinica / Org. Unit: 01
Nr. Prot. / Br. Prot. / Prot. No: 367
Nr. i fletëve / Br. stranica / No. pages: -1-
Data / Datum / Date: 23/02/2022
Prishtinë/a

# Republika e Kosovës

## Republika Kosova - Republic of Kosovo

*Qeveria - Vlada – Government*

*Zyra e Kryeministrit – Ured Premijera - Office of the Prime Minister*

Nr. 221 /2022
Datë: 23.02.2022

Kryeministri i Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 94 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 12 të Ligjit Nr. 03/L-019 për Aftësimin, Riaftësimin Profesional dhe Punësimin e Personave me Aftësi të Kufizuara, në bazë të nenit 6 paragrafi (2.1) të Rregullores (QRK) - Nr. 02/2022 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren (QRK) Nr. 04/2021, si dhe në pajtim me Vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 08/46 të datës 30.11.2021, nxjerr:

**V E N D I M**

1. Obligohen organet e administratës shtetërore që gjatë vitit 2022 të plotësojnë kuotën për punësimin e Personave me Aftësi të Kufizuar, si dhe të ndërmarrin veprime për të siguruar qasje në institucione për të punësuarit me aftësi të kufizuara, në pajtim me Ligjit Nr. 03/L-019 për Aftësimin, Riaftësimin Profesional dhe Punësimin e Personave me Aftësi të Kufizuara.

2. Obligohen institucionet përgjegjëse për zbatimin e këtij Vendimi, në pajtim me legjislacionin në fuqi.

3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryeministri.

**Albin KURTI**

Kryeministër i Republikës së Kosovës

**I'u dërgohet:**

- *Zëvendëskryeministrave;*
- *Të gjitha ministrive (ministrave);*
- *Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së;*
- *Arkivit të Qeverisë.*